

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Shërbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE
PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: *“Implementimi dhe mirëmbajtje të sistemit të faturimit, migrimi i të dhënave ofrimi shërbimit dhe integrimi i sistemit të fiskalizimit”.*

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Shërbimet e lidhura me softwaret -72260000-5

Shërbimet e asistencës së sistemeve - 72253200-5

VLERA E FONDIT LIMIT: 8.006.130 *(tetë million e gjashtë mijë e njëqind e tridhjetë)* lekë pa T.V.Sh.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit Nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të V.K.M. nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Autoriteti Kontraktor Shoqëria Rajonale U.K.Dibër Sh.a. ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë;

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

c. *Formulari Lista e Çmimeve të Shërbimeve, sipas Shtojcës 2.*

Argumentimi: Kriteret e mesiperme janë vendosur në përputhje me nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetdeklarimit” dhe neni 83 “Sigurimi i ofertës”, të ligjit nr.162/2020, “Për Prokurimin Publik” si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së nr.285, datë 19.5.2021, “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik: citojme neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, neni 82, i LPP “1. Bashkë me dorezimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si prova paraprake në vend të disa vërtetimeve të leshuara nga autoritetet publike ose pale të treta, formularin përmbledhës të vetdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për 3 vitet e fundit financiare ku vlera e xhiros minimale vjetore për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së parashikuar të kontratës. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Ky kriter i sherben autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës, prandaj është kërkuar që vlera e xhiros të jete jo më e vogël se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin 43 pika 2/ c dhe nenin 55 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.3. Kapaciteti teknik:

2.2.1 Vërtetim xhiroje vjetore nga Administrata Tatimore për 3 (tre) vitet e fundit, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së përlllogaritur të kontratës. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur në qoftë se Operatorët Ekonomike arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga AK si më lart.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të V.K.M. nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Ky kriter i sherben autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës, prandaj është kërkuar që vlera e xhiros të jetë jo më e vogël se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin 43 pika 2/ c dhe nenin 55 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.3 Kapaciteti teknik dhe profesional:

2.3.1. Furnizime të mëparshme të ngjashme me një vlerë jo më të madhe se 20% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, vërtetuar me dokumentacionin vërtetues si më poshtë:

- për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën minimalisht 20% të vlerës limit të kontratës, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2.3 Kapaciteti teknik dhe profesional:

2.3.2. Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë certifikatat e lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit të akredituara nga organizmi kombëtar i akreditimit D.P.A., ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, të jenë të vlefshme, e që kanë lidhje me objektin e kontratës, si më poshtë:

- Çertifikatë ISO 9001 mbi “Sistemet e menaxhimit te cilesise”
- Çertifikatë ISO 20000 mbi “Menaxhimin e shërbimeve të teknologjisë së informacionit”
- Çertifikatë ISO 27001 mbi “Sistemet e menaxhimit te sigurise informatike”

Argumentimi: Kërkesa më sipër është vendosur në mbështetje të nenit 36, pika 3, e ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, ku citohet:

“...3.Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar:

a) kërkesave funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t’u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën;

b) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve;

c) kërkesave në terma funksionalë sipas shkronjës “a”, referuar specifikimeve teknike sipas shkronjës “b” të kësaj pike, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale;

ç) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të këtij neni, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”...

Nëpërmjet kësaj kërkesë Autoriteti Kontraktor kërkon garantimin e një shërbimi të vijueshëm dhe cilësor për realizimin me sukses të kontratës.

Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar në mbështetje të nenit 77, pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”,

“4...Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie...”

në mbështetje të nenit 44, pika 1 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) konkretisht:

“...1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit...”,

si dhe duke u bazuar në rekomandimin e A.P.P., datë 20.03.2018, prot 3341/1, dhe më konkretisht;

a) Çertifikatë ISO 9001, për sistemin e menaxhimit të cilësisë:

ISO 9001 (ose ekuivalente) parashikon një tërësi rregullash që garantojnë një bazë rreziku parandalues ndaj cilësisë e cila mbulon një gamë të gjerë të çështjeve ku përfshihen: angazhimi i lartë i menaxhimit për cilësi nga operatori ekonomik, përshtatshmërinë e burimeve të tij, kompetencën/profesionalizmin e punonjësve, procesin e menaxhimit (për furnizim, ofrimin të shërbimeve dhe proceset mbështetëse e administrative), planifikimin e cilësisë, garantimin e një procesi cilësor të furnizimit, sigurimin e konformitetit për shërbimet, proceset e tij për të zgjidhur ankesat e klientëve, veprime korrigjuese, dhe një kërkesë për të nxitur përmirësimin. Kjo kërkesë, dëshmon se mbajtësi i saj garanton standardet ndërkombëtare të menaxhimit të cilësisë së ushtrimit të aktivitetit tregtar të tij.

Kërkesa për ISO 9001 ose ekuivalente, është një kërkesë e domosdoshme për të garantuar realizimin me sukses të kontratës.

b) Çertifikatë ISO 27001, për sistemin e menaxhimit të sigurisë së informacionit:

ISO 27001 është një kuadër standartizues në lidhje me garancitë që kërkon autoriteti kontraktor nga operatorët ekonomikë në lidhje me :

- mirëmbajtjen e sistemit ISMS (Information Security Management System) brenda vetë organizatës së operatorit ekonomik.
- aplikimin e praktikave të sigurisë për menaxhimin e risqeve të sigurisë.
- aplikimin e praktikave të sigurisë për trajtimin e të dhënave sensitive.
- aplikimin e masave dhe praktikave të sigurisë për shërbimet e kryera në ambiente sensitive.

c) Çertifikatë ISO 27001 mbi “Sistemet e menaxhimit të sigurisë informatike:

Menaxhimi i shërbimit IT siguron që operatori ekonomik ka të implementuar një sistem ofrimi të shërbimit përmes të cilit efektisht planifikon, implementon, operon, monitoron, kontrollon dhe mirëmban portofolin e shërbimeve dhe cilësinë e tyre.

Referuar sa më sipër cituar, këto standarte të kërkuara, lidhen ngushtësisht dhe drejtpërdrejtë me zërat e kërkuara objekt kontrate.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Çertifikatën e Prodhuesit për sistemin e faturimit të ofruar ose Autorizimin e Prodhuesit apo të distributorit të autorizuar për implementim e sistemit të faturimit arkëtitimit. Në Autorizim duhet të shënohen të dhënat e plota të kontaktit të prodhuesit.

2.3.4 Operatori Ekonomik duhet të jetë i licensuar nga A.K.SH.I. dhe D.P.T. për sistemin e fiskalizimit ose i autorizuar nga një prodhues i licensuar për shitjen e një produkti të licensuar të fiskalizimit.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 41, pika 4, gërma “a”, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale.

2.3.5 Për të vërtetuar që ka kapacitete njerëzore, profesionale të mjaftueshme për realizimin në kohë dhe sipas specifikimeve teknike të Kontratës, operatori ekonomik duhet të ketë një numër prej mesatarisht prej 5 (pesë) punonjësish të siguruar për 3 muajt e fundit duke ju referuar datës të publikimit të Njoftimit të Kontratës, ku përfshihet një personel teknik i diplomuar në degët e Inxhinierisë Elektronike, Inxhinieri Informatike, Teknologji Informatike, Informatikë, ose Informatikë Matematikë, Inxhinieri Matematike dhe Informatike, Informatikë Ekonomike ose Inxhinieri Telekomunikacioni që do të angazhohen në implementimin e projektit.

Çertifikimet e kërkuara janë si më poshtë:

- Të paktën 2 (dy) punonjës të çertifikuar në zhvillim dhe implementimin e sistemit të faturimit nga prodhuesi i teknologjise të sistemit. Ky kriter të plotësohet me paraqitjen e çertifikatës përkatëse për punonjësit dhe formularët E-SIG për 3 muajt e fundit duke ju referuar datës të publikimit të Njoftimit të Kontratës.***

Argumentimi. Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale të shoqërisë është kërkuar personel i nevojshëm referuar pikës 4 të Nenit 77 të Ligjit 162, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”, ku përcaktohet se “... në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e

teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie”, si dhe në mbështetje të Nenit 39 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, pika 6, germa (c) ku specifikisht përcaktohet: “Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: ... një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose...” Gjithashtu, bazuar në ligjin nr. Nr.9136, datë 11.9.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë” ku parashikohet se pagesat e kontributeve bëhen: “Nga personat juridikë, përjashtuar personat juridikë të regjistruar si tatimpagues të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël, brenda datës 20 të muajit pasardhës”, janë kërkuar listepagesat e 3 muajve.

Duke qënë se është kërkuar implementimi i një sistemi faturimi me kërkesa specifike brenda një periudhe 30 ditore, është e nevojshme që OE të ketë të paktën 2 (dy) punonjës të çertifikuar në zhvillimin e sistemit të faturimit për të përshtatur dhe mundësuar fillimisht përmbushjen e të gjitha kërkesave teknike që duhet të ofrojë sistemi dhe më pas për mirëmbajtjen e tij për një periudhë 10 mujore.

b. Të paktën 1 (një) punonjës të çertifikuar në zhvillim dhe implementimin e sistemit të fiskalizimit nga prodhuesi i teknologjise të sistemit. Ky kriter të plotësohet me paraqitjen e çertifikatës përkatësen për punonjësin dhe formularët E-SIG për 3 muajt e fundit duke ju referuar datës të publikimit të Njoftimit të Kontratës.

Argumentimi. Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale të shoqërisë është kërkuar personel i nevojshëm referuar pikës 4 të Nenit 77 të Ligjit 162, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”, ku përcaktohet se “... në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie”, si dhe në mbështetje të Nenit 39 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, pika 6, germa (c) ku specifikisht përcaktohet: “Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: ... një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose...” Gjithashtu, bazuar në ligjin nr. Nr.9136, datë 11.9.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë” ku parashikohet se pagesat e kontributeve bëhen: “Nga personat juridikë, përjashtuar personat juridikë të regjistruar si tatimpagues të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël, brenda datës 20 të muajit pasardhës”, janë kërkuar listepagesat e 3 muajve.

Është kërkuar ofrimi i shërbimit të fiskalizimit që fillimisht do duhet të integrohet me sistemin e faturimit dhe më pas ofrimi i shërbimit për një periudhë 10 mujore ndaj një ekspert i çertifikuar në teknologjinë e sistemit të fiskalizimit është i nevojshëm për të siguruar efikasitetin dhe vijueshmërinë e shërbimit të kërkuar.

c. Të paktën 1 (një) specialist të çertifikuar në konceptet e inxhinierizimit të Web shërbimeve. Ky kriter të plotësohet me paraqitjen e çertifikatës përkatësen për punonjësin dhe formularët E-SIG për 3 muajt e fundit duke ju referuar datës të publikimit të Njoftimit të Kontratës.

Argumentimi. Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale të shoqërisë është kërkuar personel i nevojshëm referuar pikës 4 të Nenit 77 të Ligjit 162, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”, ku përcaktohet se “... në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie”, si dhe në mbështetje të Nenit 39 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, pika 6, germa (c) ku specifikisht përcaktohet: “Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: ... një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose...” Gjithashtu, bazuar në ligjin nr. Nr.9136, datë 11.9.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë” ku parashikohet se pagesat e kontributeve bëhen: “Nga personat juridikë, përjashtuar personat juridikë të regjistruar si tatimpagues të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël, brenda datës 20 të muajit pasardhës”, janë kërkuar listepagesat e 3 muajve.

Është kërkuar ofrimi i shërbimeve të pagesave nëpërmjet përdorimit të Web Service dhe ofrimin e tyre për të gjithë kanalet e pagesave për një periudhë 10 mujore ndaj një eksperti i certifikuar në Web shërbime është i nevojshëm për të siguruar efikasitetin dhe vijueshmërinë e shërbimit të kërkuar.

d. Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar ITIL ose ekuivalent. Ky kriter të plotësohet me paraqitjen e certifikatës përkatëse për punonjësin dhe formularët E-SIG për 3 muajt e fundit duke ju referuar datës të publikimit të Njoftimit të Kontratës.

Argumentim: Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale të shoqërisë është kërkuar personel i nevojshëm referuar pikës 4 të Nenit 77 të Ligjit 162, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”, ku përcaktohet se “... në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie”, si dhe në mbështetje të Nenit 39 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, pika 6, germa (c) ku specifikisht përcaktohet: “Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: ... një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose...” Gjithashtu, bazuar në ligjin nr. Nr.9136, datë 11.9.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë” ku parashikohet se pagesat e kontributeve bëhen: “Nga personat juridikë, përjashtuar personat juridikë të regjistruar si tatimpagues të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël, brenda datës 20 të muajit pasardhës”, janë kërkuar listepagesat e 3 muajve.

Operatori Ekonomik duhet të ketë në stafin e tij të 1 (nje) punonjës të certifikuar për manaxhim të shërbimeve të teknologjisë së informacionit ITIL ose ekuivalent për të mundur menaxhimin korrekt të shërbimeve të IT që do të ofrohen prej tij, dokumentacionin përkatës dhe raportimin përkatës gjatë kohëzgjatjes së kontratës të mirëmbajtjes së sistemit.

- e. Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për network security. Ky kriter të plotësohet me paraqitjen e certifikatës përkatësen për punonjësin dhe formularët E-SIG për 3 muajt e fundit duke ju referuar datës të publikimit të Njoftimit të Kontratës.**

Argumentimi. Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale të shoqërisë është kërkuar personel i nevojshëm referuar pikës 4 të Nenit 77 të Ligjit 162, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”, ku përcaktohet se “... në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie”, si dhe në mbështetje të Nenit 39 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, pika 6, germa (c) ku specifikisht përcaktohet: “Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: ... një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose...” Gjithashtu, bazuar në ligjin nr. Nr.9136, datë 11.9.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë” ku parashikohet se pagesat e kontributeve bëhen: “Nga personat juridikë, përjashtuar personat juridikë të regjistruar si tatimpagues të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël, brenda datës 20 të muajit pasardhës”, janë kërkuar listepagesat e 3 muajve.

Mqs është kërkuar integrimi i dy sistemeve, ofrimi i shërbimeve në Web dhe aksesimi i tyre nga disa përdorues është i nevojshëm eksperi i certifikuar për network security për të mundur sigurinë dhe ruajtjen e të dhënave sensitive që përmbajnë database të autoritetit kontraktor.

- f. Të paktën 1 (një) punonjës Menaxher Projekti të certifikuar në PMP ose ekuivalent. Ky kriter të plotësohet me paraqitjen e certifikatës përkatësen për punonjësin dhe formularët E-SIG për 3 muajt e fundit duke ju referuar datës të publikimit të Njoftimit të Kontratës.**

Argumentimi. Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale të shoqërisë është kërkuar personel i nevojshëm referuar pikës 4 të Nenit 77 të Ligjit 162, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”, ku përcaktohet se “... në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie”, si dhe në mbështetje të Nenit 39 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, pika 6, germa (c) ku specifikisht përcaktohet: “Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: ... një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose...” Gjithashtu, bazuar në ligjin nr. Nr.9136, datë 11.9.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë” ku parashikohet se pagesat e kontributeve bëhen: “Nga personat juridikë, përjashtuar personat juridikë të regjistruar si tatimpagues të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël, brenda datës 20 të muajit pasardhës”, janë kërkuar listepagesat e 3 muajve.

Mqs natyra e shërbimeve të kërkuara dhe kompleksiteti i shërbimeve është i gjerë, është e nevojshme që OE të ketë të punësuar një Menaxher Projekti që do të jetë organizatori dhe menaxhuesi i stafit të ekspertëve, ndjekësi i fazave të realizimit të projektit dhe ndërlidhës i OE me AK

Shënim: Nje punonjës nuk mund të propozohet për më më shumë se dy pozicione të kërkuara (jo më shumë se dy certifikime).

Sqarim për ofertuesit: Në zbatim të ligjit Nr. 162/2020 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” Neni 82 dhe VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Neni 26, Neni 39, Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, Autoriteti Kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në Nenin 82, të LPP-së dhe Nenit 26 të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar.

Në çdo rast, Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të noterizuara me origjinalin.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike janë vendosur në përputhje me nenin 4, pika 38/b, nenin 36 të ligjit nr. 162/2020, “Për Prokurimin Publik”, nenin 40, pika 2, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Për objektin e prokurimit: *“Implementimi dhe mirëmbajtje të sistemit të faturimit, migrimi i të dhënave ofrimi shërbimit dhe integrimi i sistemit të fiskalizimit”*.

Specifikimet teknike gjenden pjesë përbërëse e D.T. në S.P.E. e A.P.P.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

NJËSIA E PROKURIMIT